

VENDIM
Nr.71, datë 2.2.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS QENDËR MALLAKASTËR TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Qendër Mallakastër të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 277 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër Mallakastër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qendër Mallakastër

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14, 267	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore (pronat me nr. rendor 13, 14, ndodhen brenda godinës së shkollës)	Në pronësi
15-23	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik (pronat me nr. rendor 18,20,22, ndodhen brenda godinës së shkollës)	Në pronësi
24-27, 275 (stadiumi i klubit “Bylis”, Ballsh)	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
28-45	Varreza publike	Në pronësi
46-50, 271	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
64	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
68-85	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
86-92	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive)	Në pronësi
226-227, 268	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
228-249	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
269, 270, 272, 273, 274	Troje të lira të ish-kooperativave bujqësore dhe ish-	Në përdorim

	ndërmarrjeve shtetërore	
--	-------------------------	--